



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense



Drejtoria e Burimeve Njerëzore/Direktorat Ljudskih Resurs/Human Resources Directorate

Duke marrë parasysh nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe nenin 35 paragrafi 3 i Rregullores Nr. 07/2023 për Rekrutim në FSK, nenin 17 të Rregullores Nr. 12/2023 për Zhvillimin e Karrierës së Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, si dhe duke pasur për bazë ofertën e ODC, dhe kërkesës nga G1SHPFSK nr. protokolli 4307/1, të datës 03.08.2026; Ministria e Mbrojtjes shpall:

K O N K U R S I B R E N D S H Ë M

**Për përzgjedhjen e 2 kandidatëve për studime në SHBA, në programin 13 javor
“Shkolla e Kandidatëve për Oficer” OCS**

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Kandidati që aplikon për në programin 13 javor “Shkolla e Kandidatëve për Oficer” në SHBA duhet:

- Të jetë pjesëtar aktiv i FSK-së;
- Në ditën e mbylljes së konkursit të mos jetë më i vjetër se 31 vjeç (kriter i shtetit pritës);
- Të ketë përfunduar studimet universitare civile (niveli bachelor);
- Të mos ketë shkelje disiplinore dhe të mos jetë në procedurë për shkelje disiplinore;
- Të jetë me gradë Rreshter (OR5), Rreshter Shtabor (OR6) apo Rreshter i Klasit të Parë (OR7);
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze sipas nivelit të kërkuar;

Shënim; Kandidatët e përzgjedhur pas përfundimit me sukses të programit **13 javor “Shkolla e Kandidatëve për Oficer”** do të vazhdojnë me trajnimin bazik për **Sinjale dhe Adjutant**.

Kandidatët e përzgjedhur pas përfundimit me sukses të programit **13 javor “Shkolla e Kandidatëve për Oficer”**, gradohen në gradën e Nëntogerit të FSK-së si oficer shtabi dhe karriera e tyre do të zhvillohet në fushat përkatëse. Kandidatët, të cilët nuk e përfundojnë me sukses programin, kthehen në pozitë të mëparshme ose në pozitë të lira të barasvlershme me gradën e tyre paraprake.

Testet që aplikohen:

- Testi ALCPT (testi i gjuhës angleze, min. 75%)
- Testin e inteligjencës dhe të njohurive të përgjithshme;
- Testi fizik;
- Punën ekipore dhe udhëheqjen;
- Intervista;
- Ekzaminimin shëndetësor.

Shënim: *Kalimi me sukses i testit paraprak është kusht për të drejtën e testimit në fazën vijuese.*

E drejta në ankesë

- Pas publikimit të listës fillestare, pjesëtarët e FSK-së kanë të drejtë ankese në një afat prej tri (3) ditësh pune nga dita e publikimit të listës, dhe afati i ankesës rrjedh ditën pasuese pas publikimit të listës përfundimtare.
- Ankesa i drejtohet për shqyrtim Bordit si autoritet kompetent që ka nxjerrë aktin/listën përfundimtare.
- Kur Bordi përzgjedhës vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, bën plotësimin dhe ndryshimin si dhe nxjerr listën përfundimtare.
- Kur Bordi përzgjedhës vlerëson se ankesa nuk është plotësisht e pranueshme dhe është e pabazuar, ankesën e përcjellë te Bordi për Shqyrtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave në FSK, si shkallë e dytë, me sqarimet përkatëse, dhe në afat prej 2 ditëve të punës.
- Bordi për Shqyrtimin dhe Zgjidhjen e Ankesave në FSK, brenda 5 ditëve të punës, vendos mbi ankesën dhe vendimin e dërgon te pjesëtari dhe te Bordi për Emërimet dhe Gradimet për përgatitjen e listës përfundimtare, e cila miratohet nga Komandanti i FSK-së.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Diploma universitare (bachelor),
- Ekstrakti i lindjes (jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Certifikata nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime (dokumenti të jetë i nxjerrë brenda afatit të konkursit);
- Kopje e pasaportës;
- Foto portret 4x4 për aplikim (elektronike);
- Dëshmi për kualifikime tjera (nëse posedon);
- Dokumenti i zotësisë së veprimit.

KUSHTET TJERA:

- Përzgjedhja është e kushtëzuar me kalimin e suksesshëm të procesit të verifikimit të pastërtisë së figurës.

Afati i konkurrimit;

- Konkursi i rekrutimit do të jetë i hapur prej **12.08.2026** deri më **21.08.2026**. ora 23:59.

Si të aplikoni;

Aplikimi dhe njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve është online në adresën <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> si dhe njoftimi për shpalljen e konkursit mundet ta shikoni edhe në web faqen e MM-së, <https://mod.rks-gov.net>, ku gjendet shpallja e konkursit. **Kandidatët plotësojnë formularin e aplikimit online** <https://rekrutimi.fsk-rks.org/Apply> **dhe bashkëngjisin të gjitha dokumentet tjera të kërkuara nga ky formular.** Kandidatet kanë të drejtë të aplikojnë deri në ditën e fundit të përmbylljes së konkursit. Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. Tel. 038- 555584 5690 dhe 038- 555584 5691, nga ora 09:00 deri 15:00.

Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja ofron trajtim të barabartë për të gjithë pjesëtarët e FSK-së dhe mirëpret aplikacionet e tyre, pa dallim nga përkatësia etnike apo gjinore sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs

